



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 173/prot.,
2

Tirane 02.02.2026

Lënda : Raport mbi vlerësimin përfundimtar të kandidatëve nga Këshilli i Gjykatës.

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 18, 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, më datë 27.01.2026, ora 8.30 në ambjentet e Gjykatës së Lartë u zhvillua intervista e strukturuar me gojë me kandidatët e kualifikuar nga faza e parë, që konkurronin për pozicionet vakante të shpallura në Gjykatën e Lartë me shpalljet e datës 17.12.2025, sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor” dhe “Ngritje në detyrë”

Në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë, Këshilli i Gjykatës vijoi me vlerësimin përfundimtar të kandidaturave të kualifikuara sipas pozicioneve përkatëse dhe konkretisht:

Për vendin vakant:

- **“specialist i marrëdhënieve me jashtë”**, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, kategoria ekzekutive, IV-1,

znj.Mirela Muka u vlerësua me **80.33 pikë**.

Për vendin vakant:

- **“specialist i marrëdhënieve me publikun”**, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, kategoria ekzekutive IV-1,

Znj. Nergisa Rakipi u vlerësua me **86.33 pikë**.

Për vakancën:

- “*specialist*”, Qendra e Dokumentacionit, kategoria ekzekutive, IV- I,

Znj. Andia Haxhi u vlerësua me **82.67 pikë**.

Për vakancën:

- “*sekretare gjyqësore*, sektori i regjistrimit të çështjeve gjyqësore“, Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria ekzekutive, IV- I,

Znj. Kiara Laze u vlerësua me **85.33pikë**.

Për vakancën:

- “përgjegjës sektori”, Sektori i regjistrimit të çështjeve gjyqësore, Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria e ulët drejtuese, III-1,

Znj.Erjola Pylli u vlerësua me **96.33 pikë**.

Bazuar ne vlerësimet e mësipërme Këshilli i Gjykatës mori vendimet përkatëse “Për emërimin paraprak” të kandidatëve që konkurronin sipas procedurës “Pranim në shërbimin civil gjyqësor” dhe vendimin “Për emërimin në detyrë” për kandidaten që konkurronte sipas procedurës “Ngritje në detyrë” për pozicionet vakante si më poshtë:

“Pranim në shërbimin civil gjyqësor”:

- Znj. Mirela Muka – “specialist e marrëdhënieve me jashtë”- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, me Median dhe me Jashtë.
- Znj. Nergisa Rakipi – “specialist e marrëdhënieve me publikun”- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, me Median dhe me Jashtë.
- Znj.Andia Haxhi – “specialist” – Qendra e Dokumentacionit.
- Znj.Kiara Laze – “sekretare gjyqësore” – Drejtoria e Administrimit Gjyqësor

“Ngritje në detyrë”:

- Znj. Erjola Pylli – “përgjegjëse sektori” – Drejtoria e Administrimit Gjyqësor.

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO

